

Gjergj Fishta sipas Dorëshkrimit të ndaluar të Historisë së Letërsisë Shqipe

Besa Hoxha Beqiri, Prof. Asst. Dr.

Kolegji AAB

Abstrakt

Gjergj Fishta është një ndër shkrimtarët më të analizuar të letërsisë shqiptare. Çështja e mohimit të tij gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, si dhe vlerat e pamohueshme letrare kanë bërë që studiuesit e ndryshëm ta rikthejnë fuqishëm, me gjithë faktin se Fishta ishte gjithnjë prezent. Për kohë të gjatë, në periudhën e censurës komuniste, gjegjësisht deri më 2014, është menduar dhe shkruar për ndalimin e disa shkrimtarëve të periudhës 1912-1939, përfshirë edhe Fishtën. Në një përfundim të tillë vihet nga vetë fakti se veprat e ndryshme kritike dhe të historisë së letërsisë, si dhe antologjitë e periudhës së pasluftës, qofshin shkrime individuale apo grupore, nuk kanë përfshirë Fishtën në to. Aq më tepër, pas demokratizimit të Shqipërisë, u shkrua për ndalimin e shkrimeve të Fishtës për një periudhë pothuajse gjysmëshekullore nga censura e kohës. Fishta gjatë sistemit komunist dhe përfshirja e tij në historitë e letërsisë shqipe, pas vitit 1968, vit ky i ndalimit të dorëshkrimit “Historia e letërsisë shqipe 1912 – 1939”, vlerësimi dhe mënyra e analizës së shkrimeve të Fishtës në këto histori, përfshirë edhe dorëshkrimin, janë pjesë e analizës së këtij punimi.

Fjalë kyç: *Gjergj Fishta, dorëshkrimi, historitë e letërsisë shqipe institucionale, historitë e letërsisë individuale, çështja e censurës ndaj Fishtës*

Pas rrëzimit të komunizmit në Shqipëri ka filluar me të madhe të shkruhet e të flitet për autorët e ndaluar, përveç atyre të dënuar e të anatemuar. Një gjë e tillë është bërë duke u nisur nga fakti i censurës institucionale ndaj artit në përgjithësi, përfshirë edhe shkrimet letrare.

Realizmi socialist mbetet një periudhë letrare ku kemi çdo gjë, por jo një krijimtari të ushqyer nga imagjinata dhe delli artistik. Kushtëzimet ideore dhe tematike domosdoshmërisht kanë zhveshur mundësinë e realizimit të një arti të mirëfilltë, me shumë pak përjashtime. Shqipëria nuk është shteti i vetëm i një censure dhe sistemi komunist nuk është sistemi i vetëm që shfrytëzoi censurën për të patur një letërsi (dhe tërë artin në përgjithësi) si vegël në forcimin e ideve. Censura shfaqet qysh në kohën e Neronit, perandorit romak, i cili, sipas Vasily Rudich (2013) “Dhe kjo dukshëm mundësoi *tiraninë artistike të Neronit me një program të riedukimit kulturor të popullit romak, i cili, sipas mendimeve më të fundit, u përpoq t’i zbatonte me zell*” (f. 2).

E ky brutalitet, mbase i një forme jokërcënuese për jetën e shkrimtarit, por vetëm për veprën, ishte pjesë edhe e vendeve të demokratizuara. Shembullin më të mirë të kësaj e kemi të shtjelluar në esetë e George Orwellit (2000). Ndërkaq, në letërsinë shqiptare është fituar një përshtypje e censurimit shumë më të hershëm, nga sa ka ndodhur në realitet (Hoxha Beqiri, B. 2015). Deri te kjo ka ardhur, sepse me vendosjen e një censure të rreptë shtetërore janë heshtur elementet dhe puna, gjë që ka mundur të sjellë përfundimet e një hapësire, kushtimisht thënë liberale kohore, periudhë kjo kur është punuar, edhe pse nën hijen e një fryme të diktuar, sërish me një mundësi për të nxjerrë në pah vlerat e shkrimtarëve të ndryshëm.

Mirëpo në dorëshkrimin “Historia e letërsisë shqipe 1912 – 1939”, të zbuluar nga autorja në Arkivin e Gjuhës dhe Letërsisë

Shqipe në Tiranë, na paraqitet një nga shkrimtarët e përmendur si “i ndaluar”, qysh në 1944, posa vijnë në pushtet socialistët. Në dorëshkrim, Gjergj Fishta është i analizuar thellësisht si në aspektin e jetës dhe aktiviteteve të tij atdhetare e fetare, ashtu dhe në aspektin e krijimtarisë së tij në tërësi. Duhet pasur parasysh se ky dorëshkrim, pjesë e projektit institucional me dy pjesë të botuara (Shtuteriqi et al, 1959 dhe Shuteriqi et al, 1960), pjesa e fundit e të cilit ishte e gatshme më 1965, por ndalohet vetëm kur hyn në botim më 1968, nxjerr në dritë faktin se Fishta ishte pjesë e interesimit dhe e punës hulumtuese të autorëve të këtij dorëshkrimi.

Nga ana tjetër, historitë e ndryshme të letërsisë janë të hershme. Përpjekjen e parë për një vështrim historiografik të letërsisë shqiptare e kemi qysh në shekullin XIX. A. Straticó-i shkroi “Manualin e letërsisë shqiptare” (Manuale di letteratura albanese), që u botua në Milano më 1896, ndërkaq studimi i Marchiano-s ka të bëjë kryesisht me letërsinë arbëreshe. Pastaj, me radhë vijnë: Gaetano Petrotta (2008) e Schirò (1959), Konica (2013) e Shuteriqi (1955), Àt Justin Rrota (2006) e Eqrem Çabej (1936). Gjithashtu, kemi historishkrimin e letërsisë shqipe të autorit anglez Stuart Manni (1955), si dhe të “Shkrimtarët shqiptarë, pjesa II: prej Lidhjes së Prizrenit deri sot” nga Ernest Koliqi e Namik Resuli (1941). Përveç në dy të parat, Fishta ishte analizuar në të gjitha historishkrimet e tjera, ku më shumë e ku më pak, mirëpo nuk bëhet pjesë e “Historisë së letërsisë shqipe – për shkolla të mesme” të Dhimitër Shuteriqit (1955) edhe pse ai ishte kryeredaktor i dorëshkrimit të përmendur (Hoxha Beqiri, B. 2016). Në vazhdim, përveç pasqyrit të mënyrës së trajtimit të Fishtës në dorëshkrimin e 1968-tës, jemi ndalur edhe te historishkrimet institucionale dhe individuale të paskohës së shkrimit të këtij dorëshkrimi.

Dorëshkrimi “Historia e letërsisë shqipe 1912 - 1939” dhe Fishta

Në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë së Tiranës, në mesin e shumë dorëshkrimeve gjendet edhe “Historia e letërsisë shqipe 1912 - 1939”, dorëshkrim ky, për të cilin nuk u përmend asgjë deri më 2014-n. Aq më tepër, mënyra e regjistrimit të këtij dorëshkrimi lë përshtypjen e marrjes së masave që të heshtet puna që është bërë rreth kësaj periudhe letrare. Kjo ndodh sepse dorëshkrimi në fjalë është vazhdimësi e “Historisë së letërsisë shqipe”, botimit institucional, dy pjesët e para të së cilës u botuan në vitet 1959 dhe 1960. Ky dorëshkrim ishte pjesë e këtij projekti.

“Historia e letërsisë shqipe 1912 - 1939” e pabotuar, gjegjësisht e ndaluar në proces të botimit (në boca), një dorëshkrim mjaft i pasur (i përgatitur të shtypet në dy vëllime, me gjithë faktin që ishte filluar vetëm për një vëllim) ishte punuar me përkushtim. Aty trajtohet, përveç autorëve të tjerë (autorë, të cilët janë trajtuar “të ndaluar” nga censura shtetërore) edhe Gjergj Fishta. Hapësira, e cila i është kushtuar këtij shkrimtari është e njëjtë me atë të Naim Frashërit. Ky element tregon rëndësinë që i është dhënë Fishtës nga grupi punues/redaksia (Mbi diskutimin e periudhës 1912 - 1939 të Historisë së Letërsisë Shqipe, n.d.). Në dorëshkrim është punuar në vitet e gjashtëdhjeta dhe të shtatëdhjeta, por nuk ka dokumentim të kohës së saktë. Duke pasur parasysh se ndalimi i botimit u bë më 1968, vijmë në përfundim të pashmangshëm se Fishta nuk u ndalua menjëherë pas ardhjes në pushtet të komunistëve, gjë që hedh poshtë të gjitha kritikën e pasviteve të komunizmit, ku shkruhet dhe flitet për një ndalesë të Fishtës në një periudhë 46-vjeçare.

Në dorëshkrim bëhet një trajtim i gjithanshëm i shkrimtarit (ashtu siç është vepruar edhe me shkrimtarët e tjerë në këto

vëllime, si dhe në ato të botuara) duke analizuar si jetën dhe veprimtarinë e tij, ashtu edhe veprën në të gjitha dimensionet, duke cekur që në fillim se “në letërsinë shqipe hyri një figurë e shquar, por komplekse, shkrimtar me një krijimtari të gjerë e kontradiktore...” (Historia e letërsisë shqipe 1912-1939, n.d., 122) Komplexiteti i këtij shkrimtari është element, i cili vihet në pah edhe nga kritikët e tjerë. Përveç të tjerash, në dorëshkrim ceken dy elementet kyç të krijimtarisë së Fishtës (bazuar në tematikën e trajtuar), ai patriotik dhe fetar. Kapitulli për Fishtën bën shkëputjen nga njëri te tjetri duke paraqitur shkrimtarin sa patriot dhe të angazhuar për çështjet kombëtare, aq edhe të mbyllur në gëzhjoën e petkut fetar, me përpjekje që herë pas here ta vendosë këtë element në dëm të të parit, “ai parashtroi kërkesën që letërsia të jetë ndihmëse e fesë, që shkrimtari të udhëhiqet në punën e tij letrare nga morali fetar” (f.126). Me gjithë faktin që poeti e ka thënë vetë se ideali i tij është *Atme (Atdhe) dhe Fé*, në dorëshkrim bëhet përpjekje që, në momente të caktuara, të zbehet elementi i parë në llogari të elementit fetar. Një gjë e tillë theksohet edhe kur analizohet publicistika e shkrimtarit. “Pjesa më e madhe e publicistikës së Fishtës ka karakter kontradiktor. Në të shumtën e herës ai zë pozicion prej klerikali, për të cilin interesat e kishës dhe të fesë katolike qëndrojnë mbi ato të popullit.” (f. 127).

Domosdoshmërisht që poeti në shkrimet e tij, duke përfshirë ato fetare, ishte i ndikuar nga fryma me të cilën u ushqye tërë jetën, sepse edhe ishte i përkushtuar ndaj profesionit të tij, mirëpo *morali fetar*, i cili i udhëhoqi shkrimet e Fishtës, assesi nuk ishte në dëm të çështjeve atdhetare (siç ka tendencë të paraqitet në dorëshkrim) dhe të përpjekjeve të pareshtura të tij për vetëdijësimin e popullit, por edhe të shteteve evropiane mbi gjendjen e Shqipërisë, sepse “denoncoi fuqitë e mëdha të Evropës, të cilat luanin me fatin e popujve të vegjël dhe mbrojti

me zjarr të drejtën e popullit shqiptar për vetëvendosjen dhe një jetë shtetërore të pavarur” (f.127).

Me gjithë faktin e një vlerësimi të lartë të shkrimeve dhe të angazhimit të shkrimtarit për çështje kombëtare, kemi pjesë, në brendi të kapitullit, ku bëhet përpjekje të zbehet si njëri, ashtu edhe tjetri.

Në kapitullin e dorëshkrimit (40 faqe, me makinë shkrimi, nga 275 sa kishte në tërësi dorëshkrimi), përveç paragrafit hyrës, shkruhet mbi jetën e Fishtës dhe rrethanat jetësore që ndikuan tek ai, përfshirë këtu edhe shkrimtarët e pëlqyer dhe ndikimin e letërsisë gojore, të gjitha këto gërshetuar dhe me shkrimet e tij, natyrisht duke mos anashkaluar edhe “miqësinë tradicionale me Italinë”. “Anzat e Parnazit” dhe “Gomari i Babatasit” janë shkrimet e para të analizuara në dorëshkrim, si nënkaptull më vete. “Që në fillim të krijimtarisë së vet Fishta e shfaqti veten poet me një rremb të fuqishëm dhe origjinal” (f.129), ndërsa përmbledhja e cekur vlerësohet si *një përmbledhje e poezive të tija më të mira* (fq. 129). Në vazhdim, përmbledhja analizohet në bazë të motiveve, duke filluar me atë patriotik, pa lënë anash edhe motivin e jetës së politikës ndërkombëtare. Megjithatë poemës “Palok Cuca” i bëhet një analizë shumëdimensionale, duke mos anashkaluar edhe personazhet dhe fuqinë e satirës së përdorur. Ndërsa për hartimin e “Gomarit të Babatasit” ceket se:

mori shkas nga vendimi i Ministrisë së atëhershme të Arsimit për të futur në të gjitha shkollat e Shqipërisë si në ato shtetërore, ashtu edhe në ato që mbaheshin nga kleri katolik dhe institucionet e tjera private, një program të ri dhe të njësuar, në bazë të të cilës mësimi duhej të zhvillohej në pajtim me të dhënat e shkencave pozitive.(134-135)

Pas analizës së përmbajtjes së veprës, shtjellohet thurja e veçantë e poemës, ku “ideja e saj del përmes vetëm të një pjese të subjektit” (f.135). Vihet në pah se subjekti dhe personazhet janë në funksion të asaj që të zhveshin “antipatriotizmin” e disa zyrtarëve që mbanin pozita të larta në shtet, ta godasë drejtimin e keq të vendit nga qeveritarët e kohës dhe të kritikojë me ashpërsi çrregullimet e mëdha në aparatit administrativ”(f.136). Në vazhdim, me anë të personazhit të Babatasit dhe vargjeve për të bëhet ilustrimi i satirës së Fishtës, satirë kjo që vlerësohet e qëlluar. Gjithashtu, bëhet analiza e strukturës së poemës, si dhe analiza teorike, analizë e figurave stilistike të përdorura si mjet i përforcimit të satirës së përdorur. Ndërkaq, vlera e veprës çmohet edhe për situatat komike dhe jo vetëm për fshikullimin e personave udhëheqës. “Gomari i Babatasit” në dorëshkrim vlerësohet si *vepër thellësisht publicistike*.

Në nënkapitullin “Mrrizi i zanave” Fishta vlerësohet si lirik i frymëzuar. Këtu kemi analiza të poezive të përzgjedhura, pasi që fillohet me tematikat e tyre. Radhiten motivet e poezive, që nga dashuria për gjuhën e atdheun, evokimin e së kaluarës, natyrën shqiptare, mburrjen me virtytet e besës dhe të burrërisë, e deri te nëmat për personat që nuk bëjnë asgjë që të shpëtojnë vendin nga shovinizmi serb e malazez. “Evokimi i fytyrës së Skënderbeut bëhet me një art të rrallë portretizimi” (f.139). Gjithashtu, kemi përshkrimin e mallkimit të Fishtës për Evropën, të ilustruar edhe me vargjet e tij. Vetë fakti i ndaljes tek armiqësitë e shprehura me vendet fqinje, përfshirë këtu edhe Greqinë, si dhe shtetet evropiane, por edhe Turqinë, flet mbi lirinë e redaksisë, posaçërisht të Vehbi Balës, i cili është autor i këtij kapitulli.

Në kuadër të kësaj pjese të kapitullit edhe pse jo në nëntitull, por vetëm në disa paragrafë, përmendet përmbledhja me poezi fetare “Vallja e Parrizit”. Mjaft nga vjershat vlerësohen si himne

për personazhet biblike, megjithatë një pjesë e shqipërimeve dhe e përshtatjeve thuhet se kufizoi numrin e lexuesve. Por, pavarësisht kësaj, sërish nga fundi i kësaj pjese pranohet se “ndër vjersha të tjera fetare gjejmë realizime të bukura artistike, të shkruara me një frymë të veçantë dhe Lirikat fetare të Fishtës kanë rëndësi për të njohur prozodinë dhe për të studiuar procesin e zhvillimit të gjuhës dhe të mjeshtërisë së tij” (f.143). Duhet përmendur se nga ky vëllim vlerësohen lart lirikat filozofike, në të cilat poeti trajton çështje të jetës e të vdekjes, nga *pozita të idealizmit mistik*. Nuk lihet pa u përmendur *elokuenca* e poetit, por edhe përfshirja e elementeve kozmike në këto vargje të tij.

Kapitulli vazhdohet me “Lahutën e Malcis”. Që në fillim vlerësohet si kryevepra e Fishtës dhe, njëkohësisht, “një ndër krijimet më të mëdha e më komplekse të poezisë shqipe” (f.143). Sqarohet nisma e punës me këtë poemë epike, botimet e para dhe proceset e ndryshimeve, duke përfshirë edhe ato artistike, gjatë periudhës së gjatë të shkrimit të saj. Duke pasur për bazë karakteristikat e poemës, bëhet analiza e temës dhe e strukturës së poemës. Gjithashtu, në kritikën e bërë kemi ndjekjen e vijës së konflikteve të shfaqur në vepër.

Ndërkaq, kur vjen te pjesa e “kohës së re” me ndryshimin e rrethanave, për pjesën e shkruar, bëhet ndërlidhja me moshën e autorit dhe vendin e jetesës së tij. Vihet në pah tehu i rreptë i kritikës së poetit ndaj turqve. Gjatë analizës së poemës bëhet ilustrim edhe me vargje, duke mos lënë pa i cekur vargjet që janë marrë nga populli. Realizimin më të lartë epik të Fishtës e kompletojmë edhe me portretizimet e personazheve: Oso Kuka, Ali Pashë Gucia, si dhe Tringa, edhe pse te personazhi i Tringës nuk kemi analizë të thuktë.

Natyrisht, nuk është lënë pa u kritikuar edhe kjo vepër. “Lahuta e Malcis” “është një vepër mjaft komplekse dhe kontradiktore” (Historia e Letërsisë Shqipe 1912-1939, n.d.,

f.153). Deri sa vlerësohet pozitivisht pasqyrimi i luftës së shqiptarëve për mbrojtjen e trojeve të tyre, fryma popullore e saj, si dhe ideja e veprës mbi luftën dhe përpjekjet që duhen bërë për të fituar, përmenden si koncepte të shtrembëruara, ngjyra pozitive që i është dhënë jetës patriarkale, zakoneve konservatore, si dhe mercenarizmit. Aq më tepër, shkruhet se poeti “jo gjer në fund e dalloj popullin prej klasave sunduese.” Ndërkaq, vepra vlerësohet me dobësi artistike si “zgatje, paraqitje e ngjarjeve si kronikë e thatë, radhitje e ftohtë e emrave të vendeve, përsëritje vargjesh dhe rimash etj.”, dobësi këto që nuk merren si kryesore, por që “poeti nuk e pati përherë gjer në fund frymëzimin të ngrohtë dhe të vetvetishëm si në këngët e para” (f.155). Dhe në fund të kësaj pjese bëhet vlerësimi si vepër e rrallë e këtij lloji në letërsinë shqipe, si dhe vlerësohet për lëndën e madhe historike të shprehur ndërmjet një subjekti shumëplanësh. Në fund bëhet analiza metrike e poemës, si dhe elementet romantike të saj.

Në vazhdim të kapitullit është pjesa “Dramat”. Pasi që përmenden dramat dhe tematika e shkurtër e tyre, ndalen te “Juda Makabe”. Bëhet paraqitja e subjektit dhe e personazheve, me skenat e *goditura* të tragjedisë. Edhe këtu kritikohet retorika e një pjese dhe paraqitja e përgjithësuar dhe e shpejtuar e ngjarjeve. “Ifigjia n’Aulli” dhe “Jerina ase Mbretnesha e luleve” janë dy drama të tjera ku kemi përqendrimin e kritikës për të përfunduar me përkthimet.

Kapitulli përfundon me “Arti dhe rëndësia e veprës së Fishtës”, ku tregohet koha e veprës së poetit, frymëzimi i tij, pozita e tij në lëvizjen kombëtare, por gjithashtu vihet në pah edhe se deri sa kritikoi vendet evropiane, nuk kundërshtoi imperializmin austriak. Theksohet pjesa romantike e krijimtarisë së tij, por edhe ajo realiste. Vihet në pah kontributi i tij gjuhësor, dialekti i përdorur etj.. si dhe kontributi i Fishtës në “pasurimin e vargnimit shqiptar” (f.161). Nuk anashkalohet

edhe ndikimi i shkrimeve të Fishtës te shkrimtarët e tjerë. Megjithatë, sa i përket veprës së Fishtës:

ajo paraqitet shumë e madhe në vëllim dhe po aq e pasur në lloje dhe gjini. Talent i shumanshëm, ai e shfaqti veten pothuaj po me atë forcë artistike, si në satirë ashtu edhe në dramaturgji, si në poezinë lirike, ashtu edhe në atë epike. Por ai nuk u kufizua vetëm me këto. Lëroi prozën, u muarr me publicistikë, shkroi kritikë letrare dhe studime eseistike. (f. 125).

Kështu Fishta, në këtë dorëshkrim, na paraqitet në aspektin shumëdimensional të angazhimeve dhe të shkrimeve të tij.

Gjergj Fishta - pjesë e historive të letërsisë pas dorëshkrimit

Gjergj Fishta qe pjesë e një numri të shkrimeve individuale rreth veprave tona letrare dhe historive të letërsisë shqipe. Mirëpo, disa prej tyre edhe e anashkaluan. Në këtë punim do të përqendrohemi vetëm në historitë e letërsisë institucionale dhe individuale të periudhës së pas-kohës kur u shkrua dorëshkrimi.

“Historia e letërsisë shqiptare” e vitit 1983 në Tiranë, botim ky institucional i Akademisë së Shkencave të Republikës Popullore të Shqipërisë, Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, lë plotësisht në hije Fishtën dhe shkrimet e tij. Në të vërtetë, ai përmendet si drejtues i revistës “Hylli i dritës” që “përfaqësonte reaksionin katolik dhe interesat politike të Austro - Hungarisë e pastaj të Italisë, siç do të bënte edhe gazeta “Posta e Shqypnisë” (1716-17), e cila botohej prej trupave austro - hungareze të pushtimit dhe drejtohej po nga Fishta” (Bala, et al, 1989, f.462).

Ndërkaq, te kapitujt e pjesës së letërsisë shqiptare të periudhës 1912 - 1939, në kuadër të pjesës së përgjithshme të letërsisë është shkruar vetëm një paragraf për Fishtën, si përfaqësuesi kryesor i klerit. I jepet merita e të quajturit poet, publicist, pedagog e politikan, si dhe ajo e drejtimit të shtypit françeskan. Vazhdohet me vënie në pah se “interesat” e kishës e të fesë qëndronin mbi interesat e atdheut e të popullit, gjë që ai e shpallte dhe e mbronte me tërë demagogjinë, por edhe cinizmin dhe e kishte vënë në themel të punës së tij si letrar” (f.471-472). Paragrafi vazhdon me “Lahutën e Malësisë” (siç është në libër), si vepër kryesore e Fishtës, poemë epike kjo që “duke sulmuar shovinizmin vinte në plan të dytë luftën kundër pushtuesit osman,” për ta kritikuar më tej për himnizim të “patriarkalizmit e bajraktarizmit, obskurantizmit fetar e klerikalizmit”(f.472), si dhe për spekulim me ndjenjat patriotike. Për sa i përket “Gomarit të Babatasit”, poemë kjo satirike, për të cilën thuhet se sulmoi idetë e laicizmit në shkolla, ceket dhe fakti i elementeve të përafërta me folklorin. Por artin e Fishtës “e shoqëronin shpesh proliksiteti, efektet e kërkuara, retorizmi, brutaliteti i shprehjes e i stilit, gjer në banalitet, argumentimet e tyre false, që orvaten të imponohen me pahir, si dhe një qëndrim i theksuar konservator në lëmin e gjuhës” (f.472). Paragrafi përfundon me fjalinë, e cila tregon se Fishta *mbaroi ditët* si akademik i Italisë fashiste.

Duke pasur për bazë elementet e parashtruara të dorëshkrimit, i cili, duke analizuar dokumentacionin arkivor, duhet të ketë përfunduar më 1965 dhe bazuar në këtë punë institucionale të vitit 1983, duket qartazi ndikimi i censurës në këtë të dytën. Sipas këtij vlerësimi të bërë Fishtës, ai na paraqitet si njeri antikombëtar, i cili me veprat e tij ka bërë përpjekje të zhveshë vlerat dhe të forcojë vetëm fenë dhe shtetet e huaja. Fishta, në historishkrimin e 1983-tës u përmend dhe u shtjellua shkurtimisht, si një element negativ, por edhe si poet, i

cili krijimtarinë e tij e përdori vetëm për të himnizuar të vjetrën dhe idetë fetare të shprehura me gjuhën *konservatore*. Nga ky paragraf negativ për poetin, për ata që nuk njohin shkrimet e tij, fitohet përshtypja për shkrime të pavlera.

“Historia e letërsisë shqiptare – Romantizmi I” e Rexhep Qosjes (1990), vepra voluminoze e të cilit “rrokte, në pëmasa shumë të gjera, gati shteruese, me kombinimin e disa kritereve shkencore” (Dado, 2011, f.126), paraqet Fishtën vetëm me veprën e tij romantike. Edhe pse nuk kemi kapitull të posaçëm për Fishtën, nga vetë fakti se Fishta romantik është me shumë më pak vepra sesa realist, edhe pse kryevepra e tij ishte e periudhës romantike, sërish gjejmë paraqitjen e disa elementeve të rëndësishme të këtij poeti, ndërthurur me ato të poetëve të tjerë romantikë. Siç e thotë edhe vetë Qosja, “Fishta i takon periudhës pasuese të letërsisë shqipe” (Qosja, 1990, f.38). Poeti, që fillon të shkruajë në periudhën e Romantizmit, por vazhdon edhe gjatë pas saj, shpesh dëgjon rapsodi popullore në “të cilat u këndohet trimërive imagjinare të Mujës e Halilit, shtatë shaljanëve, Marash Ucit, Oso Kukës” (f.119), prej të cilave merr shumë elemente e personazhe, por edhe “motivin e flijimit të femrës për mbrojtjen e nderit në veprën e tij “Lahuta e Malcis”” (f.119). Fishta përmendet te: çintegrimi i miteve romantike, poezia fetare, kënga epike, tipat e epizmit (ku ndalet shkurtimisht te “Lahuta” e Fishtës duke vënë paralele me “Istorin e Skenderbeut” të Naim Frashërit), te epizmi dhe lidhjet e tij jashtëtekstore, te ritmet e strukturave dhe sistemi i motivacionit e fatalizmi. Fishta, në veprën madhore të Qosjes, mbetet vetëm i ilustruar me fjali të herëpashershme lidhur me poetikën e krijimtarisë së tij romantike, pa ndonjë përkushtim më të dukshëm në analizë më të thellë të shkrimeve të tij.

Nga ana tjetër, Robert Elsie, person i përkushtuar dhe shkencëtar serioz i letërsisë sonë, sjell “Historinë e letërsisë

shqiptare” (2001), vepër kjo e botuar pas dy historishkrimeve institucionale.

Elsie e fillon kapitullin mjaft përfshirës për Fishtën me:

Figura më e madhe dhe më e fuqishme e letërsisë shqiptare të gjysmës së parë të shekullit të njëzet është ati françeskan Gjergj Fishta (1871 – 1940), i cili më shumë se cilido shkrimtar tjetër i dha shprehje artistike shpirtit kërkues të shtetit të ri sovran shqiptar. I dëgjuar dhe i ngritur lart deri në Luftën e Dytë Botërore si “poet kombëtar i Shqipërisë” dhe “Homeri shqiptar”, Fishta do të binte menjëherë në harresë kur komunistët morën pushtetin në nëntor 1944. Edhe vetëm përmendja e emrit ishte një tabu për shqiptarët, që zgjati dyzet e gjashtë vjet me radhë. (f. 193).

Elsie qysh në fillim ia bën me dije lexuesit se ka të bëjë me figurën më të madhe të letërsisë shqiptare të periudhës së tij, por që ndalohet me ardhjen në fuqi të komunizmit. Duke u nisur nga fakti i censurës në shtetet e tjera komuniste, edhe kjo censurë nuk është një element befasues për lexuesit e huaj. Natyrisht, Elsie këtë përfundim të kohës së të ndaluarit të Fishtës e ka sjellë nisur nga mospërfshirja e shkrimtarit në shkrimet ku duhej të zinte vendin qendror, sa i përket letërsisë së periudhës 1912 – 1939 apo gjysmës së parë të shekullit të njëzetë, siç e cilëson në këtë histori letrare Elsie.

Në këtë vepër gjejmë analizë këngësh për këngë të “Lahutës së Malcis”, edhe pse Gjergj Fishta “ është autor i gjithsej tridhjetë e shtatë botimeve letrare, emri i tij është i lidhur në mënyrë të pashlyeshme me një vepër të vetme, madje me një nga krijimet më mahnitëse në mbarë historinë e letërsisë shqiptare, me “*Lahuta e Malcis*”(f. 194-195).

Në vazhdim bëhet një analizë më e shkurtër dhe sipërfaqësore e veprave të Fishtës, duke përfshirë shkrimet/botimet që nga fillimi. “Vallja e Parrizit” vlerësohet si vepra që arrin kulmin në letërsinë katolike në Shqipëri, mirëpo mjeshtërinë e përkryer të Fishtës ai e sheh te poezia satirike:

Gjergj Fishta ishte gjithashtu mjeshtër i përkryer i poezisë satirike, që e përdori zgjuarsinë dhe penën e mprehtë për të qortuar cenet e sjelljes dhe plogështinë intelektuale të bashkëvendësve të vet. Ai nuk kishte ironinë dashamirëse e këshilluese të Çajupit, por satirën therëse e djegëse, shpesh të pamëshirshme, një ekuivalent ky në poezi i prozës satirike therëse të Faik bej Konicës. (Elsie, 2001, f.207)

Në kapitullin mbi Fishtën jepen vlerësimet e një numri të kritikëve shqiptarë, por edhe të huaj, me të cilat vihet në pah vlera e lartë e shkrimeve të shkrimtarit. Gjithashtu, janë dhënë arsyet e përpjekjes për ndalimin e veprave të Fishtës, si dhe mosarritja e fshirjes nga kujtesa e vargjeve të veprave të Fishtës nga vetë populli. Aty shkruhet edhe për rikthimin e Fishtës në vëmendjen e kritikës.

Elsie (2001) arrin që të portretizojë Fishtën në shumë aspekte, duke ngërthyer frymëzimin, ndikimin, vlerat e veprave të tij, figurat dominante në shërbim të vlerës artistike. Mirëpo, “pas luftës, Fishta u godit e u përgojua ndoshta më shumë se çdo shkrimtar tjetër i paraluftës dhe u la menjëherë në harresë. Poeti kombëtar u kthye në mallkim” (f.208). Vetë pjesa e përmbylljes së këtij kapitulli paraqet mendimin e fituar nga heshtja e kritikëve.

Gjithashtu, botohet edhe vepra “Gjegj Fishta” i autorit Vehbi Bala (1998), por duke qenë se ka ngjashmëri me kapitullin e dorëshkrimit të analizuar më lart, nuk do të ndalemi tek

karakteristikat e saj. Për këtë çështje mund të shihet studimi “Portretizimi i Fishtës nga Bala në periudha të ndryshme kohore” (Hoxha Beqiri, B, 2016).

Përfundime

Duke mos dashur që të komentojmë dhe të analizojmë ndryshimet e mundshme në rast se do të ishte botuar dorëshkrimi i përmendur, po japim gjykimin e Rexhep Qosjes, i cili e vlerëson “Historinë e letërsisë shqipe” të botuar në Tiranë në vitet 1959 – 1960, pa dyshim, si “teksti më i mirë i letërsisë shqipe në të cilin është bërë edhe ndarja më e sistemuar dhe më e bindshme e saj deri në ditët tona” (Qosja, 2006, f.13). Ky vlerësim kaq i lartë i punës së kësaj vepre voluminoze institucionale ka të bëjë edhe me dorëshkrimin, sepse dhe aty u vazhdua me nivelin e njëjtë.

Aq më tepër, duke pasur parasysh përmbylljen e kapitullit për Fishtë në dorëshkrim, ku për veprat e tij shkruhet se pret studiuesit e saj që të ndajnë mënjanë pjesën me brendi pozitive nga ajo që u dëmtua nga ideologjia klerikale dhe luajti një rol negativ në jetën e vendit (Historia e Letërsisë Shqipe 1912-1939, n.d. f.161), atëherë bëhet edhe më i dhimbshëm fakti i mosbotimit të dorëshkrimit.

Megjithatë, nga ajo që u shtjellua vihet lehtësisht te disa konkluzione:

- Gjergj Fishta nuk u ndalua më 1944, por më 1968.
- “Historia e letërsisë shqipe” botuar më 1959 (pjesa e parë) dhe 1960 (pjesa e dytë) pati edhe pjesën për letërsinë e vitit 1912 – 1939, dorëshkrim ky që u ndalua në procesin e botimit.
- Derisa para dorëshkrimit, gjegjësisht deri më 1941, u shkrua e u analizua vepra e Fishtës (duke mos anashkaluar edhe vëllimin përkujtimor “At Gjergj Fishta

1871 - 1940" të vitit 1943, edhe pse jo me ndonjë vlerë të dukshme), për periudhën 1944 - 1968 nuk ka ndonjë shkrim për të (as në "Historinë e letërsisë shqipe për shkolla të mesme" të Dhimitër Shuteriqit).

- Përpilimi i kapitullit për Fishtën në dorëshkrim, si dhe vetë dorëshkrimi në tërësi, mbeti i heshtur për një periudhë 46 vjeçare.
- Historitë e letërsisë shqipe/shqiptare, të kohës pas kësaj periudhe, e përmendin Fishtën vetëm në aspektin negativ; e shtjellojnë vetëm poetikën e veprës së tij romantike, por jo një analizë më vete të shkrimeve romantike të Fishtës; apo e analizojnë nga perspektiva e një të huaji që, edhe pse i bazuar në shkrimet e të tjerëve, arrin ta portretizojë mjaft mirë personalitetin e Fishtës dhe veprat e tij (posaçërisht "Lahutën e Malcis").

Nga tërë kjo, vihet në përfundim se kapitulli në dorëshkrimin e "Historisë së letërsisë shqipe 1912 - 1939" është shkruar me përkushtim dhe mbetet si dëshmi e një censure më të vonshme, nga sa është menduar. Gjithashtu, ka shumë elemente që mund të studiohen dhe të analizohen në të ardhmen.

Referencat

Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë AIGJL, Redaksia e tekstit të "Historisë së Letërsisë Shqipe", *Mbi diskutimin e periudhës 1912 - 1939 të Historisë së Letërsisë Shqipe*, Tiranë.

Bala, V. (1961), *Monografi mbi Gjergj Fishtën*, i daktilografuar, Shkodër, AIGJL, Tiranë.

Gjergj Fishta sipas Dorëshkrimit të ndaluar të Historisë së Letërsisë Shqipe

Historia e letërsisë shqipe 1912-1939, tekst i daktilografuar, 272 fl., pa datë e vit, ndoshta varianti i miratuar në vitin 1965, Arkivi i Institutit të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Tiranë.

Bala V., Brahimi R., Kodra K., Xhiku A., Fullani Dh., Çollaku Sh., Shuteriqi Dh. (1989), *Historia e letërsisë shqipe, Rilindja, Prishtinë.*

Bala, V. (1998), *Gjergj Fishta; Jeta dhe vepra, Shkodër 1961, Ombra GVG, Tiranë, 1998.*

Çabej, E. (1936), *Elementet e gjuhësisë e të literaturës shqipe me pjesë të zgjedhura për shkollat e mesme, Shtypshkronja e Ministrisë s' Arsimit, Tiranë.*

Dado, F. (2011). *Sfida teorike të historiografisë letrare, Bota shqiptare, Tiranë.*

Elsie, R. (2001). *Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë.*

Hoxha Beqiri, B. (2016), *Një histori letërsie e ndaluar; Si u ripërkthet Fishta, Konica dhe Skiroi nga "Historia e letërsisë shqipe", Naimi, Tiranë.*

Hoxha Beqiri, B. (2015), *Censorship and self censorship reflected into the History of Albanian Literature, published Journal of Modern Education Review, Volume 5, Number 8, New York, p. 812 -819.*

Hoxha Beqiri, B. (2016), *Portretizimi i Fishtës nga Bala në periudha të ndryshme kohore, Qendra e Studimeve Alanologjike, Tiranë, Studime letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate II (95-104).*

Koliqi, E., Ressuli, N. (1941), *Shkimtarët shqiptarë, pjesa II: prej Lidhjes së Prizrenit deri sot, për klasën e tretë dhe të katërt të naltë, Botim i Ministrisë s' Arsimit, Tiranë.*

Konica, F., *Shkrime nga "Albania"(1897-1909), Faik Konica, Prishtinë.*

Mann, S. (1955), *Albanian Literature – An Outline of Prose, Poetry, and Drama*, Bernard Quaritch LTD, London.

Qosja, R. (1990), *Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I, Rilindja*, Prishtinë.

Orwell, G (2000), *The collected essays, journalism and letters, Volume IV, In Front of Your Noe 1945-1950*, Nonpareil Books, London.

Petrota, G (2008), *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, Almera, Tiranë.

Rrota, J. (2006), *Letratyra shqype, për klasët të mjesme, Botime Françeskane*, Shkodër.

Rudich, V. (1997), *Dissidence and Literature under Nero: The price of Rhetoricization*, Routledge, New York.

Qosja, R. (2006), *Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.

Schirò, G. (1959), *Storia della letteratura albanese (Historia e letërsisë shqipe)*, bot. Nuova Academia, Milano.

Shuteriqi Dh., Bihiku K., Domi M., Bala V., Kodra Z., Sako Z. (1959), *Historia e letërsisë shqipe, vëllimi I*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë.

Shuteriqi Dh., Domi M., Bala V., Kodra Z. (1960), *Historia e letërsisë shqipe, vëllimi II*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë.

Shuteriqi Dh. (1955), *Historia e letërsisë shqipe për shkollat e mesme*, Ministria e Arsimit e Kulturës, Tiranë.